

LIGJ
Nr. 24/2018

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7514, DATË 30.9.1991, “PËR PAFAJËSINË,
AMNISTINË DHE REHABILITIMIN E ISH-TË DËNUARVE DHE
TË PËRNDJEKURVE POLITIKË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Pas paragrafit të fundit të shkronjës “a”, të nenit 5, të ligjit nr. 7514, datë 30.9.1991, “Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, të ndryshuar, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Koha e vuajtjes së dënimit të ish të dënuarve politikë në burgjet ku punohej në minierë në nëntokë, për efekt pensioni, njihet si punë e kryer në minierë në nëntokë. Periudha njihet sa dyfishi i periudhës së qëndrimit në këto burgje. Paga llogaritet sa paga e punës në minierë në nëntokë, sipas legjislacionit përkatës. Vërtetimi për kohën e vuajtjes së dënimit në burgjet ku punohej në minierë në nëntokë lëshohet nga Ministria e Brendshme, pas konfirmimit nga Ministria e Drejtësisë.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 10.5.2018

Shpallur me dekretin nr. 10785, datë 17.5.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta